



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

POLITIKAT E REVIZIONIMIT STATISTIKOR

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Bul. "Zhan D'ark", Nr. 3, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al

1. Hyrje

Qëllimi themelor i INSTAT është prodhimi dhe publikimi i statistikave zyrtare me cilësi të lartë, si dhe ofrimi i të dhënave dhe informacioneve përshkruese për përdoruesit e tij.

Bazuar në parimet e cilësisë, INSTAT angazhohet në matjen e cilësisë së produkteve statistikore dhe proceseve të prodhimit të tyre duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme produktet dhe aktivitetet statistikore të prodhimit të të dhënave.

Duke marrë parasysh rekomandimet e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare për cilësinë statistikore dhe politikat e rishikimit të të dhënave, INSTAT zbaton parimet e listuara më poshtë rreth rishikimit të aktiviteteve statistikore. Gjatë hartimit të këtyre parimeve, INSTAT është bazuar në përvojat e fituara gjatë dekadave të fundit dhe fushat ku parimet e rishikimit të të dhënave janë aplikuar në praktikë.

Parimet e rishikimit janë në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, direktivat e politikave të rishikimit ESS dhe udhëzimet e cilësisë të INSTAT.

- INSTAT konsideron çdo ndryshim në vlerën e të dhënave tashmë të publikuara dhe botuara si një rishikim të të dhënave. Qëllimi themelor i rishikimit të të dhënave është **përmirësimi i cilësisë së tyre**, në mënyrë që të jetë reflektive sa më saktë realitetin. Prandaj, rishikimi i të dhënave, konsiderohet një proces rutinë.
- Gjatë punës së tij, INSTAT përpiqet të prodhojë dhe publikojë të dhëna me cilësi të lartë, ku rastet e rishikimit të të dhënave të publikuara realizohen bazuar në metodologjitë përkatëse. Arsyet e rishikimit mund të jenë:
 - Marrja e një informacioni të ri pas datës së publikimit;
 - Ndryshimi i metodologjisë në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - Burime shtesë të identifikuara;
- Rishikimi i të dhënave realizohet sipas procedurave të rregulluara dhe në mënyrë transparente. Rishikimet mund të jenë të dy llojeve si më poshtë:

1. Rishikimet e planifikuara

1.1 Rishikim (Revizionim) rutinë: një ndryshim në të dhënat e publikuara, i cili rrjedh nga procesi i rregullt i prodhimit të të dhënave si: (zëvendësimi i të dhënave të cilat mungojnë dhe janë të vlerësuara me të dhëna të reja të raportuara; zëvendësimi i të dhënave paraprake me të dhënat përfundimtare; rregullimet nga efektet stinore; konsolidimi i të dhënave(benchmarkimi)).

1.2 Rishikim më i madh (thelbësor): modifikime të konsiderueshme, rishikime në të dhënat e publikuara tashmë për shkak të ndryshimeve në bazë ligjore, definicione dhe koncepte, klasifikime dhe metodologji. Rishikimet në

retrospektivë të serive kohore, në bazë të regjistrimeve të përgjithëshme (Censuse), të realizuara në çdo pesë apo dhjetë vjet; ripeshimi; ndryshimi i periudhës bazë dhe zëvendësimin e faktorëve të peshimit në indekse.

2. Rishikimet e pa planifikuara

2.1 Rishikim i pa planifikuar i të dhënave të mëparëshme, ndryshim i të dhënave si pasojë e ngjarjeve të paparashikuara (p.sh. gabimet në të dhënat e mbledhura, gabime në përpunimin e të dhënave http://www.instat.gov.al/media/371533/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf, probleme teknike, faktorët natyrorë).

- INSTAT zbaton këto parime në të gjitha seritë e të dhënave statistikore, në fusha të veçanta të ekspertizës. Rishikimi i të dhënave mund të ketë karakteristika të veçanta për fusha të ndryshme statistikore, por ky proces duhet të jetë gjithmonë në përputhje me parimet e përgjithshme të rishikimit të të dhënave.
- INSTAT vlerëson se është thelbësore që politikat e rishikimit të statistikave të specializuara duhet të jenë të qëndrueshme dhe të mirë koordinuara, jo vetëm në lidhje me fushat por dhe me të dhënat të cilat mund të lidhen me një zonat gjeografike.
- INSTAT ofron për përdorues parimet e përgjithshme të rishikimit të të dhënave, për çdo statistikë të specializuar.
- INSTAT informon përdoruesit e tij për rishikimet e planifikuara përpara publikimit të të dhënave, si dhe përcakton datën e rishikimit në Kalendarin e Publikimeve.
- INSTAT përpiqet të mbajë të qëndrueshme politikat e rishikimit për një periudhë sa më të gjatë kohore.
- INSTAT konsideron se është thelbësore që **rishikimet e pa planifikuara** ti menaxhojë në mënyrë transparente (p.sh. korigjimet e atyre gabimeve të cilat janë zbuluar - ndoshta disa vite - pas publikimit).
- INSTAT zhvillon një sistem të përshtatshëm që e përdor në botimet e tij, i cili lejon përdoruesit të identifikojnë në mënyrë të lehtë të dhënat e rishikuara. Përveç kësaj, në çdo publikim jepen shpjegime rreth arsyeve të rishikimit.
- INSTAT, në mënyrë që të sigurojë transparencën, gjithashtu ruan në kohë reale materialet fizike (pyetësorë ose publikime) si dhe databazën e të dhënave në arkivat e tij.

Publikimi i të dhënave

Në publikimet statistikore të INSTAT jepet informacion në lidhje me statusin e vlerësimit nëse të dhënat janë paraprake ose përfundimtare.

Në publikimet elektronike, ky lloj informacioni vendoset në fundin e tabelave në formatin e mëposhtëm:

Të dhëna finale;

* Të dhëna gjysëm-finale

** Të dhëna paraprake

Në Publikimin e parë, në hapësirën e dedikuar për shënime metodologjike jepet informacion kur do të publikohen të dhënat e ardhshme gjysëm finale ose finale.

Në disa Statistika të rëndësishme të shqipërisë dhe në botimet e ndryshme nga INSTAT, shënohet statusi i të dhënave vetëm në qoftë se ato janë gjysëm finale ose finale. Statusi i të dhënave përcaktohet me një shënim të vendosur:

- Në publikimet (libër ose press release) në titull, footnote me shpjegimin përkatës ku shenja vendoset poshtë tabelave, ose grafikëve.
- Në publikimin e tabelave në formatin elektronik vendoset shënimi përkatës poshtë tabelave ose grafikëve

Të dhënat përfundimtare publikohen sipas mënyrave të mëposhtëme:

- Me një Publikim dhe/ose online, kur të dhënat e publikuara janë tashmë përfundimtare (të dhënat nuk publikohen si të përkohshme);
- Me një Publikim dhe/ose online, kur të dhënat në Publikuara konsiderohen gjysëm finale;
- Me një Publikim dhe/ose online kur të dhënat konsiderohen paraprake;

INSTAT publikon politikën e rishikimit dhe praktikën e çdo statistike të specializuar në dokumentin metodologjik të statistikave në faqen e internetit. Në dokumentin metodologjik të statistikave të specializuara, INSTAT publikon programin e rishikimeve, frekuencën e rishikimeve dhe gjatësinë e rishikimeve në periudhë kohore.